



## REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

---

P. nr. 87/17

### NË EMËR TË POPULLIT

Gjykata Themelore Gjakovë/ Dega Malishevë- Departamenti i Përgjithshëm- gjyqtari i vetëm gjykues Njazi Morina, me zyrtaren ligjore Albane Morina, në lëndën penale kundër të akuzuarit I. P., nga fshati D., Komuna e Malishevës, për shkak të veprës penale vjedhje e shërbimeve komunale nga neni 320 par. 1 të KPRK-së, sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Gjakovë PP. nr. 222/17, të datës 10.03.2017, në shqyrtimi fillestar të mbajtur më datën 07.03.2019, në prezencën e prokurorit të shtetit Bajram Kryeziu, të akuzuarit I. P., më datën **11.03.2019** mori dhe publikisht shpalli këtë:

### A K T G J Y K I M

I akuzuari **I. P.**, nga i ati Q. dhe e ëma R. e gjinisë K., i lindur me datë ....., në fshatin D., komuna Malishevës, ku dhe jeton, i martuar, atë i 10 fëmijëve, me nr. personal ....., pensionist, i gjendjes së dobët ekonomike, shqiptarë, shtetas i republikës së Kosovës.

### ËSHTË FAJTOR

Sepse,

Për shkak se deri me dt. 09.08.2016, në shtëpinë e tij në fsh. D., K. Malishevë, me qëllim që ti sjellë vetit pasuri në mënyrë të kundërligjshme, ka shfrytëzuar në mënyrë të pa autorizuar energjinë elektrike, në atë mënyrë që gjatë kontrollit është konstatuar se jashtë njehsorit elektrik me nr. ...., përmes kablllos 3 x 2.5 është lidhur direkt në rrjetin elektrikë, me këtë veprim energjia elektrike e shpenzuar nuk është regjistruar, gjendje kjo e konstatuar nga personat e autorizuar të K.- it, Distrikti në Gj., me dt. 09.08.2016, me çka të dëmtuarës i ka shkaktuar dëm në vlerë prej 205.03 euro.

-më këtë ka kryer veprën penale vjedhjes së shërbimeve komunale nga neni 320 par. 1 të KPRK-së.

Andaj, gjyqtari i vetëm gjykues në bazë të nenit 4,41,42,43,46,49,50,51,52,73,74, 320 par. 1 të KPRK-së dhe neneve 248 dhe 365 të KPPRK-ës, të pandehurit i shqipton:

### **DËNIM ME KUSHT**

Ashtu që i pandehuri **I. P.** dënohet me dënim me gjobë në shumë prej njëqind (100) €, dhe me dënim me burgim në kohëzgjatje prej nëntëdhjetë (90) ditëve, të cilat dënime nuk do të ekzekutohen nëse i pandehuri në periudhën kohore prej një (1) viti nuk kryen ndonjë veprë tjetër penale.

Detyrohen i akuzuari që në emër të kompensimit të viktimave të krimit ti paguaj shpenzimet në shumën prej 20,00 €, si dhe shpenzimet e paushallit gjyqësor në shumën prej 20,00 €, në afatin prej 15 ditëve nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

E dëmtuara K.- Distrikti në Gj., për realizimin e kërkesës pasurore juridike udhëzohet në kontest civil.

### **A r s y e t i m**

Prokuroria Themelore në Gjakovë, pranë kësaj gjykate ka paraqitur aktakuzë PP. nr. 222/17, të datës 10.03.2017, kundër të akzuarit I. P., nga fshati D., Komuna e Malishevës, për shkak të veprës penale vjedhje e shërbimeve komunale nga neni 320 par. 1 të KPRK-së.

Gjykata ka caktuar dhe ka mbajtur shqyrtimin fillestar me dt. 07.03.2019, dhe pas leximit të aktakuzës nga prokurori i shtetit, të pandehurit iu dha mundësia për ta pranuar fajësinë apo të deklarohet i pafajshëm.

Pas deklarimit të pandehurit se ndjehet fajtor për kryerjen e veprës penale për të cilën akuzohet nga Prokuroria, gjykata me Aktvendim pranoi pranimin e fajësisë nga i pandehuri pasi që është bindur plotësisht se ishte i vetëdijshëm për pasojat e pranimit të fajësisë.

Prokurori i shtetit deklaroi se nuk e kundërshtoi pranimin e fajësisë nga ana e të akzuarit duke marrë parasysh se pranimin e fajësisë e ka bërë në mënyrë të vullnetshme, pa presion pasi i ka kuptuar favorët dhe pasojat e pranimit të fajësisë, po ashtu ky pranim i fajësisë gjënë mbështetje edhe në shkresat e lëndës në bazë të cilave formohet gjendja faktike e cila është përshkruar në dispozitiv të aktakuzës, ku edhe formohen elementet e veprës penale për të cilin ngarkohet i akuzuari andaj

gjykatës i propozoj që i njëjti të shpallët fajtorë, të dënohet sipas ligjit si dhe të obligohet në kompensimin e shpenzimeve procedurale.

I pandehuri I. P. i fajshëm për akuzën, më vjen keq që e kam kryer veprën penale, e kam kryer për herë të parë, më vjen keq për rastin i cili ka ndodhur, i premtoj gjykatës që në të ardhmen nuk do të kryej kurrfarë veprë penale.

Nga thëniet e vet të pandehurit në shqyrtimin fillestarë u vërtetua se ai me datë, kohë dhe vend si në dispozitivin e aktakuzës së ngritur ndaj tij ka kryer veprën penale për të cilën akuzohet.

Po ashtu nga shkresat e lëndës dhe nga provat materiale siç janë: K., procesverbal nr. ...., dt. 09.08.2016; foto dokumentacioni; K./C. ID. ...., dt. 10.08.2016; fatura D., dt. 10.08.2016, si dhe shkresat tjera te lendes.

Gjykata me pranimin i fajësisë nga i pandehuri ka vlerësuar se janë përmbushur kushtet ligjore që pranimi i fajësisë të aprovohet nga ana e gjykatës. Gjykata ka pranuar deklarin e pranimi të fajësisë nga i pandehuri dhe vlerëson se ky pranim i fajësisë është i mbështetur edhe në provat që gjenden në shkresat e lëndës, të gjitha këto vërtetojnë në mënyrë bindëse për gjykatën elementet inkriminuese të veprës penale e ku krijohet edhe figura në tërësi e veprës penale që ka kryer i pandehuri, andaj mbi këtë bazë edhe gjykata i ka vlerësuar këto prova dhe deklarin e pranimi të fajësisë nga i pandehuri e ka pranuar si të tillë.

Gjyqtari me rastin e matjes së dënimit ka marrë për bazë edhe rrethanat që ndikojnë në llojin dhe lartësinë e dënimit duke u bazuar në nenet 73,74,75 dhe 76 të KPRK-së, ashtu që rrethanë posaçërisht lehtësuese ka marrë faktin se i pandehuri ka pranuar fajësinë për veprën penale për të cilën akuzohet, është hera e parë që e ka kryer një vepër penale, është i gjendjes së dobët ekonomike, pensionist, i vjete keq që ka ndodhur, i premtion gjykatës se nuk do ta përsërite një vepër tjetër penale, ndërsa si rrethanë rënduese gjykata mori faktin se me këtë lloj të veprës penale është bere keqpërdorimi i rrymës te kompanisë te dëmtuar, po ashtu edhe mënyrën e kryerjes së kësaj vepre penale si dhe motivin e kryerjes së kësaj vepre penale e cila në këtë rast ishte përfitimi i kundërligjshëm i energjisë elektrike për vete, të gjitha këto rrethana ndikuan që Gjykata ti zbatoi dispozitat e zbutjes së dënimit të parapara me nenin 73 të KPRK-së, Gjykata të akuzuarit i shqiptoi dënim me gjobë në shumë prej njëqind (100) €, dhe me dënim me burgim në kohëzgjatje prej nëntëdhjete (90) ditëve, të cilat dënime nuk do të ekzekutohen nëse i pandehuri në periudhën kohore prej një (1) viti nuk kryen ndonjë vepër tjetër penale, me bindje se edhe me këtë dënim do të arrihet qëllimi i dënimit i paraparë me dispozitën e nenit 41 të KPRK-së.

Vendimi për shpenzimet e procedurës penale dhe paushallit gjyqësor është marr bazuar në nenin 450 par. 1 dhe 2 nën par. 2.6 të KPP-së, si dhe bazuar në nenin 39 par. 3 nën par. 3.2 te Ligjit për Kompensimin e Viktimave të Krimit nr. 05/L-036.

Vendimi për udhëzimin e palës së dëmtuar në kontest civil, për realizim e kërkesës pasurore juridike, është marrë bazuar në nenin 463 paragrafi 2 të KPPK-së.

Nga sa u tha më lart, e në bazë të nenit 365 të KPPK, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA THEMELORE GJAKOVË/ DEGA MALISHEVË**  
**DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM**  
**P. nr. 87/17, Datë: 11.03.2019**

**Zyrtarja ligjore**  
Albane Morina

\_\_\_\_\_

**Gjyqtari**  
Njazi MORINA

\_\_\_\_\_

**KËSHILLË JURIDIKE:**

Kundër këtij aktgjykimi palët kanë të drejtë ankese në Gjykatën e Apelit në Prishtinë, në afat prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh, llogaritur nga dita e pranimt të tij. Ankesa dorëzohet përmes kësaj Gjykate, në kopje të mjaftueshme për palët dhe gjykatën.